



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja b), nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja l), të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 10, paragrafi 2 dhe nenit 17 të Ligjit 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH- nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH - nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe të nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja b), nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110- 391, dt. 28.03.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.3.2025, merr këtë

V E N D I M
PËR DEFINIMIN E KUFIRIT MES BLOKUT A6 dhe A7 TË PLANIT
RREGULLUES
“PRISHTINA E RE – ZONA QENDËR”

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për definimin e kufirit mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”.

Neni 2

Qëllimi i hartimit

1. Me definimin e kufirit mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, do të precizohet kufiri mes blloqeve të lartcekura dhe kushteve ndërtimore sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht do të rregullohet mospërputhja e definimit të kufirit në mes të hartës “09 Ndarja e blloqeve” dhe “20 Parcelimi”.
2. Parcelat e Zonës kadastrale, nr.: 1060-8, 1060-9, 1060-10, 1060-11, 1060-12, 1060-13, 1060-14, 1060-15, 1060-16 dhe 1060-1, do t’i takojnë bllokut A6 dhe do të mbajnë parametrat e bllokut me ISPN më të ulët, respektivisht 2.8.

Neni 3

Kufiri i territorit

Zona për të cilën bëhet definimi i kufirit mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” përfshinë sipërfaqe prej **S= 5318 m²**.

Neni 4
Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të definimit të kufirit mes blloqeve është Drejtoria e Planifikimit e Komunës së Prishtinës.

Neni 5
Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor, janë të siguruara nga buxheti i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës.

Neni 6
Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat për 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 7
Konsultimet publike

Para finalizimit, Vendimi për definimin e kufirit mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, do të vihet në konsultime publike. Koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallet përmes njoftimeve publike, konform nenit 8 të Udhëzimit administrativ, nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, ku shqyrtimi publik do të zgjatë 15 ditë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-015/01-45624/25, më 2.4.2025

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



ARSYETIM

PËR DEFINIMIN E KUFIRIT MES BLOKUT A6 dhe A7 TË PLANIT RREGULLUES “PRISHTINA E RE – ZONA QENDËR”

Hyrje

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, dhe duke u bazuar në kërkesën e qytetarëve për të investuar në këtë zonë, me nr. 05-070/01-0029924/25 të datës 27.02,2025, Komuna e Prishtinës e sheh të domosdoshëm definimin e kufirit në mes të bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, me qëllim të krijimit të mundësisë të zhvillimit të blloqeve në fjalë në përputhshmëri me planin.

Inicimi i tillë është bërë bazuar në dokumentin e planifikimit hapësinor, Planin zhvillimor komunal të Komunës në fuqi, Planit rregullues në fjalë dhe Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor (neni 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nënparagrafi 1.6. i Ligjit).

Fushëveprimi

Definimi i kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, do të precizojë kufirin mes blloqeve të lartcekura dhe kushtet ndërtimore sipas Ligjit për Planifikim hapësinor, 04/L-174, Udhëzimit administrativ MMPH - nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH - nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Qëllimi

Sipas Planit rregullues aktual “Prishtina e Re – Zona Qendër”, të vitit 2013, ekziston mospërputhje e definimit grafik në mes Bllokut A6 dhe A7, konkretisht mospërputhje të definimit të kufirit në mes hartës “09 Ndarja e blloqeve” dhe asaj “20 Riparcelimi”.

Në hartën “09 Ndarja e blloqeve”, parcelat në ZK Matëçan, me numra kadastralë: 1060- 8,1060-9, 1060-10, 1060-11, 1060-12, 1060-13, 1060-14, 1060-15, 1060-16 dhe 1060-1

i takojnë bllokut A7, ndërsa në hartën “20 Riparcelimi” të njëjtat i takojnë bllokut A6.

Me qëllim të mundësisë së realizimit të bllokut është e domosdoshme që kjo mospërputhje të definohet. Duke u nisur nga fakti se të gjitha blloqet e planit janë ndarë në bazë të principit të ndjekjes së gjeometrisë së rregullt gjatë formimit të bllokut, propozohet që parcelat në fjalë t'i takojnë bllokut A6, duke i dhënë edhe atij formën e rregullt gjeometrike, ashtu siç është e përfshirë edhe në hartën “20 Riparcelimi” sipas planit ekzistues.

Meqenëse parametrat e zhvillimit të blloqeve A6 dhe A7 në pjesën e Indeksit të sipërfaqes së përgjithshme (ISPN), ndryshojnë, respektivisht:

A6: ISPN 3.5

A7: ISPN 2.8


në bazë të këtij vendimi parcelat në fjalë të cilat kalojnë në bllokun A6, mbajnë parametrat e bllokut me ISPN-në më të ulët, respektivisht 2.8.

Kufiri i sipërfaqes së trajtuar

Zona për të cilën bëhet definimi i kufirit mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, përfshinë sipërfaqe prej $S = 5318 \text{ m}^2$.

Komuna do të publikojë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim, dhe kjo periudhë do të zgjatë 15 ditë.


Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, do ta menaxhojë procesin e hartimit të planit përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda Komunës.



1. Harta “09 Blloqet”, Plani rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”



2. Harta "20 Riparcelim", Plani rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër"



3. Parcelat subjekt i korrigjimit të kufirit në mes bllokut A6 dhe A7, Plani rregullues
 “Prishtina e Re – Zona Qendër”